Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	5	877,869,242	895,848,938
Aktivet afatgjata jomateriale	6	1,617,101,309	1,818,699,953
Asete ne perdorim	7	60,742,813	-
Llogari të arkëtueshme të tjera	8	61,270,011	104,802,387
Shpenzime të shtyra	9	919,820,683	761,499,177
Pjesëmarrje në njësi të kontrolluara	10	46,601,198	46,701,198
Totali i aktiveve afatgjata		**3,583,405,256**	**3,627,551,653**
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	11	333,382,408	285,509,051
Llogari të arkëtueshme tregtare	12	950,942,332	708,799,171
Llogari të arkëtueshme të tjera	13	88,016,412	52,717,201
Tatim fitimi	34	10,029,058	13,887,669
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	14	866,748,360	1,009,772,939
Mjetet monetare në arkë e në bankë	15	168,401,324	69,805,389
Totali i aktiveve afatshkurtra		**2,417,519,894**	**2,140,491,420**
Totali i aktiveve		**6,000,925,150**	**5,768,043,073**
KAPITALI			
Kapitali aksionar		230,076,000	230,076,000
Rezerva përkthimi		5,384,215	3,106,790
Rezerva ligjore		23,007,600	23,007,600
Fitime/(Humbje të mbartura)		(45,079)	(44,692,565)
Fitimi i ushtrimit		173,444,191	118,717,310
Totali i kapitalit	16	**431,866,927**	**330,215,135**
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	17	315,149,183	335,076,176
Detyrime per qira financiare	21	32,455,417	-
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	34	401,240	401,240
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	18	21,244,409	23,742,996
Detyrime të tjera afatgjata	19	265,900,000	540,920,000
Totali i detyrimeve afatgjata		**635,150,249**	**900,140,412**
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	20	833,639,847	765,391,591
Detyrime per qira financiare	21	37,810,963	-
Llogari të pagueshme tregtare	22	1,863,578,770	1,675,025,977
Detyrime tatimore	23	138,931,319	88,280,514
Tatim fitimi	34	374,771	-
Parapagimet e arkëtuara	24	27,738,258	46,741,312
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	25	1,630,673,372	1,509,782,095
Llogari të pagueshme të tjera	26	401,160,674	452,466,037
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**4,933,907,974**	**4,537,687,526**
Totali i detyrimeve		**5,569,058,223**	**5,437,827,938**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**6,000,925,150**	**5,768,043,073**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 -37, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PLATFORMË TELEVIZIVE DIXHITALE TOKËSORE DHE SATELITORE
DigitAlb
info@digitalb.tv • www.digitalb.al

Pasqyra e Fitim ose Humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	27	5,252,206,013	5,506,673,952
Të ardhura të tjera	28	70,947,356	168,554,155
Total të ardhura		**5,323,153,369**	**5,675,228,107**
Materiale dhe shërbime direkte	29	(3,871,724,398)	(3,966,097,775)
Shpenzime personeli	30	(323,751,796)	(291,698,265)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	31	(463,854,058)	(636,646,279)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	32	(475,843,063)	(610,726,689)
Total shpenzime		**(5,135,173,315)**	**(5,505,169,008)**
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	33	(64,246,872)	(52,150,664)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	34	93,393,749	41,032,016
Fitimi/humbja para tatimit		**217,126,931**	**158,940,451**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	35	**(43,682,740)**	**(40,223,141)**
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(43,682,740)	(40,223,141)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		**173,444,191**	**118,717,310**
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		2,277,425	1,647,822
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		**2,277,425**	**1,647,822**
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		**175,721,616**	**120,365,132**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 37, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

PLATFORMË TELEVIZIVE DIXHITALE TOKËSORE DHE SATELITORE
DigitAlb
info@digitalb.tv • www.digitalb.al

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		217,126,931	158,940,451
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		466,742,522	643,855,981
(Të ardhura)/humbje nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale		-	(36,794)
Nxjerrja jashtë përdorimit e Mjeteve fikseve, neto nga fitimi kapital		11,086,316	5,968,682
Shpenzime për interesa		64,860,574	53,505,439
Diferenca perkthimi nga asetet		9,255	(265,196)
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues		**759,825,598**	**861,968,563**
Ndryshimi në kapitalin qarkullues			
Ndryshimi në inventar		(55,396,762)	(153,790,451)
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme dhe të tjera		(251,956,358)	33,888,805
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera		(87,121,765)	(481,794,935)
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra		(15,296,927)	(317,959,899)
Ndryshimi në grante dhe të ardhura të shtyra		99,389,636	61,760,694
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		**449,443,422**	**4,072,777**
Interesa të paguara		(64,860,574)	(53,505,439)
Tatimi i paguar mbi dividendin		(2,285,144)	-
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		(39,449,357)	(22,458,242)
		(106,595,075)	**(75,963,681)**
Aktivitetet investuese			
Blerje të aktiveve afatgjata materiale		(158,299,719)	(89,508,860)
Blerje të aktiveve afatgjata jomateriale		(20,866,069)	(41,236,502)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale		17,143	169,562
(Blerje)/shitje e shoqërisë së konrolluar minus paratë e arkëtuara		100,000	(3,500,000)
Dalja për parapagime për asete		-	(90,000)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues		**(179,048,645)**	**(134,165,800)**
Aktivitetet financuese			
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata		(19,926,993)	(25,703,850)
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër		68,248,256	94,565,423
(Ripagim)/ të hyra nga detyrime per qira financiare		(66,270,284)	-
Dividendë paguar		(49,532,171)	-
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues		**(67,481,192)**	**68,861,573**
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		**96,318,510**	**(137,195,131)**
Mjetet monetare në fillim të periudhës		69,805,389	205,352,698
Diferenca përkthimi		*2,277,425*	*1,647,822*
Mjetet monetare në fund të periudhës	12	**168,401,324**	**69,805,389**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 – 37, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

PLATFORMË TELEVIZIVE DIXHITALE TOKËSORE DHE SATELITORE • DigitAlb • info@digitalb.tv • www.digitalb.al

Pasqyra e ndryshimeve ne Kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

	Kapitali aksionar	Rezerva perkthimi	Rezerva ligjore	Fitime te mbartura /humbje te akumuluara	/(Humbje) Ushtrimit	Totali
Pozicioni financiar me 01 janar 2016	**230,076,000**	**1,458,968**	**23,007,600**	**(252,550,085)**	**207,857,520**	**209,850,003**
Dividende te paguar						
Humbje nga perthithja				207,857,520	(207,857,520)	
Totali I te ardhurave gjithperfshirese		1,647,822			118,717,310	**120,365,132**
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2016	**230,076,000**	**3,106,790**	**23,007,600**	**(44,692,565)**	**118,717,310**	**330,215,135**
Efekti nga ndryshimi ne politika kontabel				(22,252,509)		**(22,252,509)**
Transferim I fitimit te mbartur				118,717,310	(118,717,310)	
Dividende te paguar				(51,817,315)		**(51,817,315)**
Totali I te ardhurave gjithperfshirese		2,277,425			173,444,191	**175,721,616**
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2017	**230,076,000**	**5,384,215**	**23,007,600**	**(45,079)**	**173,444,191**	**431,866,927**

Pasqyrat financiare duhet te lexohen se bashku me shenimet shpjeguese te faqeve 7 - 37, te cilat jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare

Keto pasqyra financiare jane aprovuar nga Administratori i Digit-Alb sh.a me_ 15 mars 2018 dhe jane nenshkruar per publikim ne emer te tyre nga:

Znj.Teuta Nuni
Hartues i Pasqyrave Financiare

Z. Alban Jaho
Administrator

PLATFORMA TELEVIZIVE DIXHITALE TOKËSORE DHE SATELITORE
DigitAlb
info@digitalb.tv • www.digitalb.al

DIGIT-ALB sh.a
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Së bashku me opinionin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE :	
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-37

1. Informacion i përgjithshëm

DIGIT-ALB sh.a ("Shoqëria") është krijuar juridikisht më 23.04.2004, regjistruar më 18.05.2004 në QKR. Më 31 dhjetor 2016 pronësia e kapitalit zotërohet nga disa aksionerë.
Kapitali i Shoqërisë është 230,076,000 lekë, i ndarë në 230,076 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë secili.
Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ndërtimi dhe tregtimi i sistemeve të telekomunikacionit, prodhimi i shërbimeve audio dhe video.
Përfaqësues Ligjor i Shoqërisë është z.Alban Jaho.
Shoqëria drejtohet nga Këshilli Mbikqyrës i cili përbëhet nga:

- Petraq Shomo
- Edmond Leka
- Vjollca Hoxha
- Eduard Poda
- Iva Çamuku
- Arben Taipi
- Ilir Karaguni

Selia e Shoqërisë ndodhet në Rrugen "Pavarësia", Nr. 39, Kashar, Tiranë.
Shoqëria ështe regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT K41719004D.
Pasqyrat financiare janë paraqitur të konsoliduara për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2017 duke perfshire edhe degën në Kosovë.

Shoqëria më 31 dhjetor 2017 kishte 358 punonjës të regjistruar (31 dhjetor 2016: 346).

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet, amendimet dhe interpretimet në vijim, hyjnë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 janar 2017 ose pas kësaj date:

- *Përmirësimet vjetore të SNRF (Cikli 2014 - 2016): SNRF 12 Shpalosjen e interesave në njësi të tjera*
- *SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat (Amendim – Njohja e taksës së shtyrë si aset për humbje të parealizuara)*
- *SNK 7 Pasqyra e Flukseve Monetare (Shpalosjen e Amendimeve fillestare)*

Nuk ka patur standarde apo interpretime të reja, të cilat kanë hyrë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2017 ose pas kësaj date, që të kenë efekt të qenësishëm në pasqyrat financiare të shoqërisë.

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emetuar por nuk janë ende efektive:

- SNRF 9 Blerësit e instrumentave financiarë (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2018 ose pas kësaj date)
- SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me blerësit (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2018 ose pas kësaj date); dhe
- SNRF 16 Qiratë (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2019 ose pas kësaj date)
- Të tjera

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

2.2. Standardet dhe interpretimet e emetuara (vazhdim)

Shoqeria ka zgjedhur vullnetarisht të aplikoj SNRF 15 për hërë të parë në raportimin financiar të vitit 2017 (aplikimi fillestar në datë 1 janar 2017) dhe ka zgjedhur një aplikim retrospektiv të modifikuar të metodës së kerkuar në SNRF 15, duke qe ne se nuk ka efekt në fitimet e pashpërndara.
Standardi i ri bazohet në parimin se të ardhurat njihen kur kontrolli i një malli apo shërmbimi transferohet tek klienti- pra koncepti i kontrollit zëvendësohet me konceptin ekzistues të rrezikut dhe perfitimeve. SNRF-15 kërkon që shuma totale e përfituar duhet të ndahet në zërat dhe mallrat bazuar në çmimet e shitjes dhe jo në bazë të vlerës së mbetur.

Kjo do të rezultojë në shuma më të mëdha të shpërndara tek mallrat e shitur dhe gjithashtu në një njohje të hershme të pjesës të të ardhurave. Si rezultat I këtij rregullimi kontabël, fitimet e pashpërndara në 01 janar 2017 nuk do të ndryshojnë duke qënë se nuk ka patur shitje paketash përpara vitit financiar 2017.
Procesi me pesë hapa i shpjeguar më poshtë aplikohet përpara se e ardhura të njihet: • identifikimi i kontratave me klientët • identifikimi i detyrimit të veçantë të performancës • përcaktimi i çmimit të transaksionit të kontratës • shpërndarja e çmimit të transaksionit ndaj secilit prej detyrimeve të veçantë të performancës • njohja e të ardhurave sipas përmbushjes së secilit detyrim të performancës.

Ndryshimi kryesor nga standardi i ri është se çdo paketë të mallrave ose shërbimesh e cila mund të dallohet, njihet në mënyrë të veçantë, dhe çdo zbritje në çmimin e kontratës duhet të njihet në elementin specifik.

Gjithashtu, shoqeria ka zgjedhur vullnetarisht të aplikoj SNRF 16 për herë të parë në raportimin financiar të vitit 2017 (aplikimi fillestar në datë 1 janar 2017) dhe ka zgjedhur një aplikim retrospektiv të modifikuar. Për këtë arsye informacioni krahasues nuk është riparaqitur dhe vazhdon të raportohet sipas SNK 17. Detajet e politikave kontabël sipas SNK 17 janë shpjeguar veçmas nëse ato janë të ndryshme nga politikat sipas SNRF 16 dhe ndikimi i ndryshimeve është shpalosur në Shënimin nr.4.9.

2.3 . Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Shoqëria nuk parashikon standard të tjerë të publikuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël, që nuk janë në përdorim, të kenë ndikim material në pasqyrat financiare.

- KIRFN 22 Përkthimin e Monedhave të huaja dhe Vlerësimin në Avancë (në fuqi më 1 Janar 2018)
- Amendime të klasifikimeve të SNRF 2 dhe Matja e Transaksioneve me Pagesë Aksionesh (në fuqi më 1 Janar 2018)
- Amendime të SNRF 4: Aplikimi i SNRF 9 Instrumentet Financiar me IFRS 4 Kontratat e Sigurimit (në fuqi më 1 Janar 2018)
- Amendime të SNA 40: Transfertat e Pasurive Investuese (në fuqi më 1 Janar 2018)
- Përmirësime vjetore të Standardeve SNRF, cikli 2014 – 2016, që ndeshet me çështjet e SNRF 1 për herë të parë
- Adoptimi dhe SNA 28 Investime në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (në fuqi më 1 Janar 2018)
- KIRFN 23 Paqartësi mbi Pozicionin e Taksës mbi të Ardhurat (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)
- Amendime të SNRF 9 Karakteristikat e Parapagimeve me Kompensim Negativ (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)
- Amendime të SNA 28: Interesat Afatgjatë në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (hyn në fuqi më 1 Janar 2021)

Shoqëria ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Shoqëria parashikon se përvetesimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

3. Bazat e përgatitjes

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Pasqyrat financiare janë paraqitur të konsoliduara për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2017 edhe degën në Kosovë.

3.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") te BSNK-së.

3.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Bazat e konsolidimit

Filialet janë të gjitha subjektet (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) mbi të cilat Grupi ka fuqi për të qeverisur politikat financiare dhe operative, që në përgjithësi u atribuohen aksionereve që zotërojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme janë konsideruar kur është bërë vlerësimi nëse Grupi kontrollon një njësi tjetër ekonomike. Filialet janë konsoliduar plotësisht që nga data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Metoda e kostos është përdorur për të kontabilizuar blerjen e filialeve nga Grupi. Kostoja e blerjes është matur në vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna, instrumentave të kapitalit neto të emetuara dhe detyrimeve të pësuara ose konstatuara në datën e këmbimit, plus kostot direkte të blerjes. Aktivet e identifikueshme të blera dhe detyrimet e konstatuara në një kombinim biznesi njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga interesi i pakicës. Tejkalimi i kostos së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës të grupit të aktiveve neto të identifikueshme njihet si emri i mirë. Transaksionet midis shoqërive të grupit, balancat dhe fitimet e parealizuara për transaksione ndërmjet shoqërive të grupit janë eliminuar. Gjithashtu janë eleminuar humbjet e parealizuara. Politikat kontabël të filialeve janë ndryshuar kur ka qenë e nevojshme për t'u përputhur me politikat e miratuara nga Grupi.

3.6. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

3.6. Vlerësime dhe gjykime (vazhdiim)

3.6.1. Jeta e dobishme e aktiveve

Përcaktimi i jetës së dobishme të aktiveve bazohet në përvojën historike me asete të ngjashme si dhe çdo zhvillim teknologjik të parashikuar dhe ndryshimet në faktorët ekonomikë e industrialë. Përshtatshmëria e vlerësimeve të jetës së dobishme të aktiveve rishikohet çdo vit, ose në çdo kohë kur ka një tregues për ndryshime të rëndësishme në supozimet themelore. Ky është një vlerësim kontabël kritik për shkak se përfshin supozime mbi zhvillimet teknologjike, në një degë shumë inovative si telekomunikacioni.

3.6.2. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.6.3. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3.6.4 Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera , me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe ne llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

4. Politikat Kontabël

Me përjashtim të ndonjë efekti që mund të rrjedhë nga ndryshimet në politikat kontabël të përshkruar në shënimin 2.2 të këtyre pasqyrave financiare, shoqëria ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme politikat kontabël të paraqitura në vijim:

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
EUR/LEK	132.95	135.23
USD/LEK	111.10	128.17
CHF/LEK	113.94	126.05
GBP/LEK	149.95	157.55

4.2. Instrumentat financiare

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.
Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv nëse është materiale.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.
Interesat e përllogaritura janë njohur në pasqyrën e të ardhura-shpenzimeve dhe si detyrim në llogarinë interesa të përllogaritura.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivet dhe pasivet financiare kompensohen dhe paraqiten neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe qëllimi që shlyerja të realizohet mbi baza neto, apo të realizohet aktivi dhe të shlyhet detyrimi njëkohësisht. Kjo vlen kryesisht për balancat ndaj/dhe nga operatorët e tjerë të telekomunikacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat shlyhen në shumën neto, në përputhje me kontratat ekzistuese.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me , paraqiten me vlerën më të ulët mes kostos dhe vlerës së realizueshme neto.. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përllogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit minus kostot e përllogaritura për përfundimin dhe realizimin e shitje
Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.
Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.
Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.
Për të përcaktur nëse një aktiv që ka në përbërjen e tij si elemente materialë ashtu dhe jomaterialë, duhet të trajtohet sipas SNK 16 - Aktivet Afatgjata Materiale apo sipas SNK 38 - Aktive afatgjata jomateriale, manaxhimi përdor gjykimin për të përcaktuar se cili element është më i rëndësishëm, në mënyrë që të rregjistrojë aktivin siç duhet.
Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi (vazhdim)

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit	
		2017	2016
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%	20%
Instalime Teknike specfike	Vlera e mbetur	20%	20%
Instalime Teknike Kompekse	Vlera historike/vlera e mbetur	7.5%	20%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%	20%

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabël tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivet paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim.

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proçes që nuk janë në funksionim.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.
Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:
është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.
Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.
Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelrësimi.
Aktivet jo-materiale, Emri i mire gjate vitit ushtrimor është amortizouar me normën 7.5% mbi koston historike, kurse aktivet e tjera jomateriale me norme 15% te kostos historike.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.6. Aktive në përdorim

Shoqëria njeh të drejtën e përdorimit të një aktivi dhe një detyrim qiraje në datën e fillimit të qirasë.
Aktivi me të drejtën e përdorimit fillimisht matet me kosto, i cili përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesë qiraje të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo shpenzim fillestar të drejtpërdrejtë të kryer dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe largimin ose rivendosjen e aktivit ose zonës së vendndodhjes në të cilën është, duke zbritur cdo përfitim të marrë.
Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet më pas duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit deri në fund të jetës së dobishme të aktivit ose në fund të afatit të qirasë financiare.

4.7. Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.
Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

4.8. Të ardhurat

Të ardhurat njihen kur kontrolli i një malli ose shërbimi transferohet tek një klient. Të ardhurat njihen në bazë të shumës së specifikuar së kontratës me klientin dhe përjashton shumat e mbledhura për interesat e palëve të treta. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasinë (volumin) e blerë.

Shoqëria fiton shumicën e të ardhurave të saj nga shitja e mallrave (dekoderave dhe aksesorëve) dhe shitjes së shërbimeve (abonim në platformat Digitalb). Prodhimet dhe shërbimet mund të shiten ndaras ose në paketa. Gjatësia tipike e një kontrate për paketat është 1 deri në 12 muaj.

Për paketat e ofruara shoqëria njeh produktet ose shërbimet individuale si të shiteshin veçantë, nëse një produkt ose shërbim mund të identifikohet veçmas nga mallrat ose shërbimet e tjera dhe nëse një klient mund të përfitojë prej tij. Përfitimi shpërndahet mes produkteve dhe shërbimeve të veçanta të një pakete bazuar në çmimet individuale të tyre, nëse do të shiteshin veçmas. Këto çmime përcaktohen nga lista e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve që shoqëria ofron.

Mallrat

Të ardhurat nga shitja e dekoderave dhe aksesoreve, neto nga uljet e lejuara, njihen në ne momentin e dorëzimit të mallit te klienti kur e drejta e pronësisë dhe rreziku i humbjes i kalojnë klientit.

Abonimet

Të ardhurat nga shërbimet regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion më përfundimin e shërbimit në datën e raportimit dhe vetëm kur ato mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

4.9. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate dhe Të ardhura nga veprimtari Të tjera jooperative.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.10. Qiratë

Shoqëria ka aplikuar SNRF 16 duke përdorur metoden retrospektive të modifikuar dhe për këtë arsye informacioni krahasues nuk është riparaqitur dhe vazhdon të raportohet sipas SNK 17.

Politika te aplikueshme prej 1 Janarit 2017

Në fillim të një kontrate, Shoqëria vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një kontratë qiraje financiare. Një kontratë është ose përmban një kontratë qiraje financiare nëse kontrata përcakton të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të nje përfitimi të marrë.

Për të vlerësuar nëse një kontratë përcakton të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar, Shoqëria vlerëson nëse:
- kontrata përfshin përdorimin e një aktivi të identifikuar - kjo mund të specifikohet në mënyrë eksplicite ose implicite dhe duhet të jetë fizikisht e dallueshme ose të përfaqësojë në thelb të gjithë kapacitetin e një pasurie fizikisht të dallueshme. Nëse furnizuesi ka një të drejtë zëvendësimi substancial, atëherë aseti nuk identifikohet;
- Shoqëria ka të drejtë të përfitojë në mënyrë të konsiderueshme të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivit gjatë gjithë periudhës së përdorimit; dhe
- Shoqëria ka të drejtën të drejtojë përdorimin e aktivit. Shoqëria ka këtë të drejtë kur ka të drejtat e vendimmarrjes që janë më të rëndësishme për të ndryshuar mënyrën dhe për çfarë qëllimi përdoret aktivi.

Kjo politikë zbatohet për kontratat e lidhura ose të ndryshuara, në ose pas 1 janarit 2017.

Politika te aplikueshme perpara 1 Janarit 2017

Për kontratat e lidhura para datës 1 janar 2017, Shoqëria ka përcaktuar nëse marrëveshja ka qenë ose përmbante një kontratë qiraje financiare bazuar në vlerësimin nëse:

- përmbushja e marrëveshjes ishte e varur nga përdorimi i një aktivi ose pasurish të veçantë; dhe
- marrëveshja kishte përcjellë të drejtën e përdorimit të pasurisë. Një marrëveshje e ka përcjellë të drejtën e përdorimit të aktivit nëse një nga këto është përmbushur:
- blerësi kishte aftësinë ose të drejtën për të përdorur aktivin gjatë marrjes ose kontrollit të më shumë se një sasie të parëndësishme të perfitimeve;
- blerësi kishte aftësinë ose të drejtën për të kontrolluar aksesin fizik të aktivit gjatë marrjes ose kontrollit të më shumë se një sasie të parëndësishme të prodhimit; ose
- Faktet dhe rrethanat treguan se ishte e largët që palët e tjera do të merrnin më shumë sesa një sasi e parëndësishme të perfitimeve, dhe çmimi për njësi nuk ishte as fikse për njësi të output-it dhe as e barabartë me çmimin aktual të tregut për njësi të output-it.

Qiramarrësi

Shoqëria njeh të drejtën e përdorimit të një aktivi dhe një detyrim qiraje në datën e fillimit të qirasë.
Aktivi me të drejtën e përdorimit fillimisht matet me kosto, i cili përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesë qiraje të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo shpenzim fillestar të drejtpërdrejtë të kryer dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe largimin ose rivendosjen e aktivit ose zonës së vendndodhjes në të cilën është, duke zbritur cdo përfitim të marrë.
Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet më pas duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit deri në fund të jetës së dobishme të aktivit ose në fund të afatit të qirasë financiare.
Detyrimi i qirasë financiare fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk paguhen në datën e fillimit, të zbritura duke përdorur normën e interesit të përcaktuar në kontratë ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht,normen e interesit te humarrjeve nga shoqëria. Në përgjithësi, Shoqëria përdor normën e interesit te mjedisit ekonomik si normën e zbritjes.
Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.
Kur detyrimi i qirasë rishikohet, një rregullim korrespondues bëhet në vlerën kontabël të aktivit ose regjistrohet në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e aktivit është reduktuar në zero.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.10. Qiratë

Qiratë financiare afat-shkurtra dhe qiratë financiare për asete me vlerë të vogël

Shoqëria ka zgjedhur të mos njohë aktivet dhe detyrimet e qirave financiare për qira afatshkurtra të makinerive që kanë një kontratë me afat 12 muaj ose më pak dhe dhënien me qira të aktiveve me vlerë të ulët, duke përfshirë pajisjet informatike. Shoqëria njeh pagesat e qirave që lidhen me këto lloj aktivesh si një shpenzim në bazë lineare gjatë afatit të qirasë financiare.

4.11. Grantet

Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila njihet si e ardhur në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera të përgjithshme në mënyrë sistematike dhe proporcionale përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

4.12. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.
Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.13. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.
Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 eshte 15% (2016: 15%).
Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.
Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

4.14. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.15. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.16. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.17. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.18. Krahasueshmeria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivishte. Ndryshimet përfshijne riklasifikime brenda zërave të seksionit të aktiveve dhe pasiveve në pasqyrën e pozicionit financiar si edhe në pasqyrën e fitim humbjes.

(Vlerat janë në Lek)

5. Aktivet afatgjata materiale

	Ndërtesa	Instalime teknike	Makineri pajisje energjitike	Pajisje informatike	Mobilje & Pajisje Zyre	Mjete transporti	Instrumenta e veglapune	Të tjera në shfrytezim	Investim ne ambjente me qira	Totali
Kosto										
Gjendja më 1 janar 2016	142,431,417	1,919,266,646	100,586,102	144,091,387	82,095,823	63,225,774	9,918,491	24,941,677	208,492,994	**2,695,050,311**
Shtesa		75,674,747	300,639	12,163,507	1,204,712			165,255	20,358,239	**109,867,099**
Nxjerrje jashtë përdorimi		(22,635,522)	(5,922,560)	(15,278,928)	(23,019,367)			(4,222,833)		**(71,079,210)**
Transferime në shpenzime për t'u shpërndarë dega Kosovë		(926,326)								**(926,326)**
Pakësime						(1,284,200)				**(1,284,200)**
Gjendja më 31 dhjetor 2016	**142,431,417**	**1,971,379,545**	**94,964,181**	**140,975,966**	**60,281,168**	**61,941,574**	**9,918,491**	**20,884,099**	**228,851,233**	**2,731,627,674**
Riklasfikime		*38,890*		*8,335,641*	*(14,238,481)*		*(38,890)*	*5,902,840*		-
Gjendja pas riklasifikimeve me 1 janar 2017	**142,431,417**	**1,971,418,435**	**94,964,181**	**149,311,607**	**46,042,687**	**61,941,574**	**9,879,601**	**26,786,939**	**228,851,233**	**2,731,627,674**
Shtesa		106,169,424	826,072	24,048,450	3,923,071	14,330,380	1,716,904	1,863,145	5,422,273	**158,299,719**
Nxjerrje jashtë përdorimi					(9,871,478)	(22,026,935)	(1,817,519)			**(33,715,932)**
Pakësime					(73,800)					**(73,800)**
Gjendja më 31 dhjetor 2017	**142,431,417**	**2,077,587,859**	**95,790,253**	**173,360,057**	**40,020,480**	**54,245,019**	**9,778,986**	**28,650,084**	**234,273,506**	**2,856,137,661**
Amortizimi i akumuluar										
Gjendja më 1 janar 2016	36,311,554	1,387,792,524	66,403,174	85,377,691	57,505,000	32,648,246	6,529,800	16,089,396	29,873,632	**1,718,531,017**
Amortizimi i vitit	5,305,993	114,607,459	6,880,210	15,687,912	5,373,075	6,113,184	689,255	1,792,116	27,054,566	**183,503,770**
Nxjerrje jashtë përdorimi		(21,062,494)	(5,378,339)	(14,653,223)	(20,236,503)			(3,779,970)		**(65,110,529)**
Pakësime						(1,151,431)				**(1,151,431)**
Gjendja më 31 dhjetor 2016	**41,617,547**	**1,481,337,489**	**67,905,045**	**86,412,380**	**42,641,572**	**37,609,999**	**7,219,055**	**14,101,542**	**56,928,198**	**1,835,772,827**
Sistemime		33,844		6,797,911	(11,628,394)		(33,844)	4,830,483		-
Gjendja pas riklasifikimeve me 1 janar 2017	**41,617,547**	**1,481,371,333**	**67,905,045**	**93,210,291**	**31,013,178**	**37,609,999**	**7,185,211**	**18,932,025**	**56,928,198**	**1,835,772,827**
Amortizimi i vitit	5,040,694	98,926,156	5,533,157	12,313,063	4,000,375	5,774,184	826,135	1,772,173	30,980,762	**165,166,699**
Nxjerrje jashtë përdorimi					(8,150,625)	(12,773,253)	(1,705,738)			**(22,629,616)**
Pakësime					(56,657)					**(56,657)**
Gjendja më 31 dhjetor 2017	**46,658,241**	**1,580,297,489**	**73,438,202**	**105,523,354**	**26,806,271**	**30,610,930**	**6,305,608**	**20,704,198**	**87,908,960**	**1,978,253,253**
Vlera neto kontabël										
Efekti nga përkthimet e degës 2016										**(5,909)**
Gjendja më 31 dhjetor 2016	**100,813,870**	**490,047,102**	**27,059,136**	**56,101,316**	**15,029,509**	**24,331,575**	**2,694,390**	**7,854,914**	**171,923,035**	**895,848,938**
Efekti nga përkthimet e degës 2017										***(15,166)***
Gjendja më 31 dhjetor 2017	**95,773,176**	**497,290,370**	**22,352,051**	**67,836,703**	**13,214,209**	**23,634,089**	**3,473,378**	**7,945,886**	**146,364,546**	**877,869,242**

6. Aktive afatgjata jomateriale

Në zërin aktive afatgjata jomateriale janë paraqitur licenca dhe emri i mirë. Balancat më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2016	2,834,477,728	2,834,477,728
Shtesa	41,236,502	41,236,502
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	**2,875,714,230**	**2,875,714,230**
Shtesa	20,866,069	20,866,069
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	**2,896,580,299**	**2,896,580,299**
Amortizimi		-
Gjendja më 1 janar 2016	631,055,355	631,055,355
Shtesa	425,958,922	425,958,922
Pakesime		
Gjendja më 31 dhjetor 2016	**1,057,014,277**	**1,057,014,277**
Amortizimi i vitit	222,464,713	222,464,713
Kthim amortizimi		-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	**1,279,478,990**	**1,279,478,990**
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2016	**1,818,699,953**	**1,818,699,953**
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2017	**1,617,101,309**	**1,617,101,309**

7. Asete në përdorim

Në këtë zë janë paraqitur asetet në përdorim, balanca e të cilave më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	Ndertesa	Stacione	Mjete transporti	Asete në përdorim
Me kosto				
Gjendja më 1 janar 2017	314,956,231	66,004,103	10,727,452	391,687,786
Shtesa	3,110,571		3,340,523	6,451,094
Pakësime				-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	**318,066,802**	**66,004,103**	**14,067,975**	**398,138,880**
Amortizimi akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2017	241,780,023	38,725,530	3,349,172	283,854,725
Shtesa	39,724,626	10,647,702	3,169,014	53,541,342
Pakesime				-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	**281,504,649**	**49,373,232**	**6,518,186**	**337,396,067**
Gjendja Neto më 01 janar 2017	**73,176,208**	**27,278,573**	**7,378,280**	**107,833,061**
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2017	**36,562,153**	**16,630,871**	**7,549,789**	**60,742,813**

8. Llogari të arkëtueshme të tjera afatgjata

Në këtë zë janë garancitë për qira dhe garanci të tjera , balanca e të cilave më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Garanci për qira	57,064,653	100,597,029
Garanci të tjera	4,205,358	4,205,358
	61,270,011	**104,802,387**

9. Shpenzimet e shtyra afatgjatë

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime të shtyra afatgjatë për të drejta dhe produksione	919,820,683	761,499,177
	919,820,683	**761,499,177**

10. Pjesëmarrje në njësi të kontrolluara

Pjesëmarrjet në njësitë e kontrolluara detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aksione ne shoqerine Shqip shpk (100%)	-	100,000
Aksione ne shoqerine Empire shpk (95%)	43,101,198	43,101,198
Aksione shoq. ADTN	3,500,000	3,500,000
	46,601,198	**46,701,198**

11. Inventari

Balanca e inventarit të shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Lëndë djegëse	2,153,582	2,272,764
Lëndë e parë	2,730,709	1,085,261
Materiale ndihmëse	1,069,075	1,074,898
Mallra për rishitje	354,571,351	300,695,032
Zhvlerësim malli	(27,142,309)	(19,618,904)
	333,382,408	**285,509,051**

Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarit :

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Gjendja më 1 janar	19,618,904	6,689,270
Rimarrje për vitin	-	-
Zhvlerësimi për vitin	7,523,405	12,929,634
Gjendja më 31 dhjetor	**27,142,309**	**19,618,904**

12. Llogari të arkëtueshme tregtare

Gjendja e llogarive të arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Klientë	1,019,298,560	767,525,503
Zhvlerësim i llogarive te arkëtueshme	(68,356,228)	(58,726,332)
	950,942,332	**708,799,171**

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Gjendja më 1 janar	58,726,332	38,184,415
Rimarrje për vitin	(1,700,752)	(5,777,221)
Zhvlerësimi për vitin	11,330,648	26,319,138
Gjendja më 31 dhjetor	**68,356,228**	**58,726,332**

13. Llogari të arkëtueshme të tjera afatshkurtër

Llogaritë e arkëtueshme të tjera të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Hua të dhëna	25,169,363	24,381,891
Top Channel	9,000,000	16,000,000
ADTN	21,582,000	9,882,000
Të arkëtueshme nga aksionerët	27,615,975	-
TVSH për koeficentin e kreditimit	11,004,225	-
Të tjera	249,064	564,881
Tëe arkëtueshme nga tatimet	1,812,253	1,812,253
Tatim fitimi dega Kosovë	-	76,176
Zhvlerësim i llogarive të tjera të arkëtueshme	(8,416,468)	-
	88,016,412	**52,717,201**

14. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet ndaj furnitorëve dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Parapagime për furnitorët	34,618,261	28,010,281
Parapagime për asete	-	33,458,504
Shpenzime të shtyra të drejta dhe produksione	728,017,783	871,827,939
Shpenzime të shtyra komisione për abonime	84,032,484	55,721,686
Shpenzime të shtyra të tjera	20,079,832	20,754,529
	866,748,360	**1,009,772,939**

15. Mjete monetare

Balancat e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si në vijim:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete monetare në bankë	**116,097,198**	**55,417,513**
Llogari rrjedhëse	116,097,198	55,417,513
Depozita me afat	-	-
Mjete monetare në arkë	2,140,683	874,626
Likujditete ne tranzit	50,163,443	13,513,250
	168,401,324	**69,805,389**

16. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2017 është në vlerën 230,076,000 Lekë, i cili zotërohet nga aksionerët e shoqërisë.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Numri aksioneve	230,076	230,076
Vlera nominale	1,000	1,000
	230,076,000	**230,076,000**

Rezervat ligjore të shoqërisë më 31 dhjetor 2017 janë në vlerën 23,007,600 Lekë, njësoj si edhe vitin e kaluar.
Fitimet/ (Humbjet) e mbartura më 31 dhjetor 2017 janë në vlerën (45,079) Lekë.
Rezervat e përkthimit të shoqërisë më 31 dhjetor 2017 janë në vlerë 5,384,215 Lekë.

17. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përfaqësojnë vlerën e marrë hua në tre banka:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Pjesa afatgjatë e huasë - Union Bank	41,822,362	24,466,280
Pjesa afatgjatë e huasë - Societe Generale	57,041,795	167,349,832
Pjesa afatgjatë e huasë-Raiffeisen	216,285,026	143,260,064
	315,149,183	**335,076,176**

18. Detyrime për qira financiare

Detyrimet per qira financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrime per qira financiare afatgjatë	32,455,417	
Detyrime per qira financiare afatshkurtër	37,810,963	
	70,266,380	-

19. Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime afatgjata

Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë :

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Grante Afatgjatë - Pajisjet Eutelsat	21,244,409	21,253,575
Grante të tjera afatgjatë	-	2,489,421
	21,244,409	**23,742,996**

20. Detyrime të tjera afatgjata

Detyrimet e tjera afatgjata me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrime për blerjen e aksioneve Super Sport	265,900,000	540,920,000
	265,900,000	**540,920,000**

21. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë Union Bank	49,763,700	46,573,354
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë Societe Generale Bank	119,287,257	105,463,269
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë Raiffeisen Bank	119,749,420	43,357,336
Overdraft Raiffeisen Bank	-	139,246,008
Overdraft Societe Generale Bank	319,851,965	336,899,402
Overdraft Tirana Bank	132,741,864	-
Overdraft Union Bank	92,199,309	93,852,222
Detyrime për kartë krediti	46,332	-
	833,639,847	**765,391,591**

21. Hua (vazhdim)

Huatë paraqiten të detajuara më poshtë më 31 dhjetor 2017:

BANKA	Lloji Financimit	Monedha	Nr.interesit	Principali i mbetur i huasë në monedhë	Data e disbursim it	Data e maturimit	Shuma Ekuivalente ne ALL	Shuma deri ne 1 vit	Shuma mbi nje 1 vit
Union Bank	Kredi	EUR	norma baze e interesit + 3.5 % jo me pak se 6.4 %	180,923	25-Jun-15	25-Jun-18	24,053,774	24,053,774	-
Union Bank	Kredi	EUR	norma baze e interesit + 3.5 % jo me pak se 6.4 %	507,953	27-Jun-17	27-Jun-20	67,532,288	25,709,926	41,822,362
Societe Generale Albania	Kredi	ALL	bono thesari 12 M + 1.5 % jo me pak se 4.5%	1,326,281	1-Sep-15	30-Jun-19	176,329,052	119,287,257	57,041,795
Raiffeisen Bank	Kredi	EUR	Euribor 12 M + 4% jo me pak se 4.8%	2,527,525	30-Dec-16	30-Dec-20	336,034,446	119,749,420	216,285,026
Societe Generale Albania	Overdraft	ALL	bono thesari 12 M + 1.5 % jo me pak se 4.5%	906,460	18-Sep-17	18-Sep-18	120,513,900	120,513,900	-
Societe Generale Albania	Overdraft	EUR	LIBOR EUR 12M+ 3.5% in year , jo me pak se 4 %	1,499,346	18-Sep-17	18-Sep-18	199,338,065	199,338,065	-
Tirana Bank	Overdraft	EUR	Euribor 12 M + 3.5% jo me pak se 4.2%	998,434	9-Aug-17	8-Aug-18	132,741,864	132,741,864	-
Union Bank	Overdraft	EUR	5.4%	693,489	14-Nov-17	14-Nov-18	92,199,309	92,199,309	-
Union Bank	Karte krediti	EUR		348			46,332	46,332	-
Total 31 Dhjetor 2017							**1,148,789,030**	**833,639,847**	**315,149,183**

22. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogari të pagueshme tregtare	1,863,578,770	1,675,025,977
	1,863,578,770	**1,675,025,977**

23. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrime për sigurime shoqërore & shëndetësore	6,870,691	4,922,346
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	2,473,524	1,423,044
Tatim në burim	187,653	6,634,517
TVSH për t'u paguar	129,399,451	75,300,607
	138,931,319	**88,280,514**

24. Parapagime të arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Parapagime të arkëtuara	27,738,258	46,741,312
	27,738,258	**46,741,312**

25. Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime afatshkurtra

Grantet dhe të ardhurat e shtyra afatshkurtra të shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhura të shtyra	1,625,295,487	1,501,554,100
Grante Afatshkurtër - Pajisjet Eutelsat	2,888,464	5,767,762
Grante të tjera	2,489,421	2,460,233
	1,630,673,372	**1,509,782,095**

26. Llogari të tjera të pagueshme

Llogari të tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Dividend për t'u paguar	24,690,954	152,517,152
Furnitorë për fatura të pambërritura	54,721,226	49,118,803
Detyrime të tjera	345,779	654,582
Detyrime për blerjen e aksioneve Super Sport	321,402,715	250,175,500
	401,160,674	**452,466,037**

27. Të ardhura

Të ardhurat nga aktiviteti operativ për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja e mallrave	374,253,900	245,604,918
Të ardhura nga abonimet	2,797,305,929	3,063,861,456
Të ardhura nga të drejtat e ritransmetimit nga partnerët	1,763,516,797	1,678,594,496
Të ardhura nga transmetimi n ë platformën Digitalb	109,549,386	129,102,861
Të ardhura shitje te drejta televizive	68,824,136	138,155,983
Të ardhura nga reklamat	138,755,865	251,354,238
	5,252,206,013	**5,506,673,952**

28. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera jo operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Upgrade software/simulkripte	50,198,610	69,838,660
Të ardhura nga qeraja	4,475,724	3,792,280
Të ardhura nga shërbime të tjera	16,273,022	80,974,450
Të ardhura nga rimarrja e grantit	-	13,911,971
Të ardhura nga shitja e aseteve	-	36,794
	70,947,356	**168,554,155**

Rakordimi i të ardhurave me FDP:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Qarkullim i tatueshëm	5,324,094,748
Shtohen të ardhurat e rimarra nga 2016 për abonimet DGA, IPKO, Abcom	1,501,554,100
Zbriten të ardhura të shtyra DGA, IPKO, Abcom për 2018	(1,476,059,113)
Zbriten të ardhura nga shitja e aktiveve dhe rivlerësimi	(39,371,601)
Ndryshimi në parapagimet shtohet parapagimi kaluar ne te ardhura	19,003,055
Zbritet të ardhura nga shitja e aktiveve (paraqitur neto)	(17,143)
Zbriten të ardhurat nga transporti dhe telefoni, paraqitur ne zvogelim te shpenzime dhe diference kursi	(1,353,998)
Zbriten të ardhurat TCH pozicionuar ne shpenzime	(4,126,323)
Zbriten të ardhura financiare me faturë kaluat ne te ardhura financiare	(570,356)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	5,323,153,369
Sipas Kontabilitetit	5,323,153,369
Diferenca	-

29. Materiale dhe shërbime direkte

Shpenzimet për materiale dhe shërbime direkte për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Mallra e aksesorë	424,630,395	338,964,531
Mallra dhe materiale të tjera	7,452,652	13,681,000
Të drejta transmetimi dhe kosto teknike	2,649,469,665	2,795,244,268
Licenca dhe qira transmetimi	619,145,521	621,397,413
Komisione për mallra dhe abonime	148,180,003	155,244,960
Shërbime prodhimi produksion	22,846,162	41,565,603
	3,871,724,398	**3,966,097,775**

30. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për paga	263,880,893	237,574,396
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	38,197,795	34,741,184
Shpenzime të tjera për punonjësit	21,673,108	19,382,685
	323,751,796	**291,698,265**

Në shpenzimet e personelit janë të perfshira edhe shpenzimet për personelin e Digitalb Dega në Kosovë.

Shpenzime për paga dhe shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore të vitit 2017 të Digitalb sha Shqipëri janë përkatësisht në vlerat 247,856,166 Lekë dhe 37,426,088 Lekë.

31. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime amortizimi dhe konsumi	441,172,753	609,462,691
Shpenzime zhvlerësimi kliente	11,330,648	22,653,740
Rimarrja provizionit	(1,700,752)	(1,190,084)
Shpenzime zhvlerësimi te tjera te arketueshme	8,416,468	-
Shpenzime zhvlerësimi inventar	7,523,405	12,929,634
Të ardhura nga rimarrja grantit	(2,888,464)	(7,209,702)
	463,854,058	**636,646,279**

32. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Blerje energji,avull,ujë, karburant	67,413,068	59,487,451
Shpenzime qeraje	18,307,889	90,725,907
Mirëmbajtje dhe riparime	62,201,157	55,762,754
Sigurime	7,633,689	6,881,052
Blerje të ndryshme,kancelari etj	12,808,895	14,255,043
Shërbime nga të tretë	38,497,975	46,643,444
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	18,926,182	20,442,682
Shpenzime për reklama	182,513,263	228,115,402
Shpenzime për udhëtime dhe dieta	16,896,542	21,051,723
Shpenzime transpoti	10,613,695	6,984,888
Komisione bankare	9,848,426	11,190,977
Sponsorizime	158,950	5,436,868
Taksa të ndryshme	3,369,319	2,587,692
Gjoba të ndryshme	255,035	228,144
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	21,301,902	34,963,980
Vlera kontabël e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi	11,113,126	5,968,682
Rimburism nga kompani sigurimi	(6,016,050)	-
	475,843,063	**610,726,689**

Rezultati neto nga shitja e AAM-ve:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja	17,143	169,562
Vlera kontabël e aktiveve të shitura	(1,876,587)	(132,768)
Rezultati neto	**(1,859,444)**	**36,794**

33. Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)

Shpenzimet e interesit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për interesa	(64,846,574)	(53,505,439)
Të ardhura nga interesat	613,702	1,354,775
	(64,232,872)	**(52,150,664)**

34. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Shpenzimet e tjera financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Humbje nga këmbimet valutore	(86,698,336)	(48,106,735)
Të ardhura nga këmbimet valutore	173,514,058	86,705,403
Të ardhura të tjera financiare	6,578,027	2,433,348
	93,393,749	**41,032,016**

35. Tatimi mbi fitimin

Përllogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit (Digitalb indvidiual)	**217,126,931**	**158,940,451**
Shpenzime te panjohura (si me poshte)	**75,792,088**	**110,403,908**
Shpenzime per dhurata	7,071,930	7,967,905
Shpenzime udhetimi, dieta	2,793,688	4,744,750
Penalitet, gjoba e demshperblime	255,035	-
TVSH rivleresimi etj.	8,614,295	25,478,427
Shpenzime interesash te panjohura	3,988,681	2,877,522
Shpenzime zhvleresimi (provizione)	27,270,521	35,583,374
Shpenzime te tjera	25,415,297	33,516,144
Shpenzime dega Kosove	382,641	235,786
Te ardhura te patatueshme	**(1,700,752)**	**(1,190,084)**
rimarrje provizioni	(1,700,752)	(1,190,084)
Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)	**291,218,267**	**268,154,275**
	291,218,267	**268,154,275**
Tatim fitimi @15%	(43,682,740)	(40,223,141)
Shpenzime tatim fitimi i shtyre		
	173,444,191	**118,717,310**

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Tatim fitimi i parapaguar 1 Janar	**13,887,669**	**31,652,568**
Tatim fitimi i parapaguar	29,420,300	22,458,242
Tatim fitimi i vitit	(43,682,740)	(40,223,141)
Tatim fitimi i parapaguarDigitalb sh.a	**(374,771)**	**13,887,669**
Total fitimi per t'u paguar Digitalb Shqiperi	(374,771)	-
Tatimi fitimi I parapaguar Dega kosove	10,029,058	-

36. Palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura të përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohet si më poshtë:

Llogari të arkëtueshme:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Top Channel	66,494,400	66,494,400
Union Distribucion Sh.p.k	20,367,897	20,595,044
Plus Communication	3,643,149	5,791,443
Easypay	20,865,959	16,558,899
Top Albania Radio	1,364,206	1,386,739
GEN-D Marketing & Consulting	1,019,102	524,310
PAY DGA	3,475,313	2,757,267
Valtelina	1,130,610	463,840
Urban Digital Entert. Systems	106,360	3,448
SICRED sha	972,694	2,186,455
Media Union	692,711	-
Empire	97,634	576,444
	120,230,035	**117,338,289**

Llogari të tjera të arkëtueshme:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Top Channel	5,974,200	26,681,439
Top Channel	9,000,000	16,000,000
Vjollca Hoxha	20,411,282	-
Loresa shpk	7,204,693	-
	42,590,175	**42,681,439**

Llogari të pagueshme:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Top Channel	16,219,744	301,328
Union Distribucion Sh.p.k	2,357,767	1,252,997
Plus	172,796	29,683
Easypay	2,437,258	502,887
Top Albania Radio	1,392,570	1,400,890
Valtelina	1,106,861	
SICRED sha	973,059	7,347,258
Empire	-	354,079
Enel	1,787,011	901,824
Albanian Courier	99,943	99,344
S-Sistem	239,310	292,097
Automaster	266,604	226,657
Media Union	212,000	110,000
Union Travel shpk	199,159	209,930
Total	**27,464,082**	**13,028,974**

36. Palët e lidhura (vazhdim)

Transaksionet me palët e lidhura të përfshirë në pasqyrën e performancës financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

Shitje ndaj palëve të lidhura:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Top Channel	4,626,323	57,907,851
Union Distribucion Sh.p.k	151,596,785	184,328,380
Plus Communication	1,073,441	6,571,260
Easypay	186,326,619	244,013,235
Union Bank	-	6,409,002
GEN-D Marketing & Consulting	1,669,735	6,901,729
PAY DGA	13,183,457	18,773,369
Valtelina	555,642	386,533
Urban Digital Entert. Systems	106,384	108,491
SICRED sha	4,560,439	5,978,689
Shqip shpk	-	500,000
Empire	49,645	480,997
	363,748,470	**532,359,536**

Transaksionet me palët e lidhura të përfshirë në pasqyrën e performancës financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

Blerje nga palët e lidhura:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Top Channel	306,475,985	288,641,160
UDSA	12,730,764	14,686,024
Plus Communication	798,510	1,596,854
Easy Pay	16,763,082	21,094,286
Top Albania Radio	6,370,885	6,591,920
Valtelina	1,106,861	-
Mercuri	132,200	88,500
SICRED sha	-	5,061,000
Shqip	-	14,000,000
Empire	13,001	-
Enel	8,996,602	9,209,357
Albanian Courier	491,840	642,554
S-Sistem	4,038,138	3,198,821
Automaster	1,876,681	1,491,022
Media Union	102,000	65,000
	359,896,549	**366,366,498**

Balancat dhe transaksionet e mësipërme vijnë nga aktiviteti përditshëm i biznesit dhe janë kryer në kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

Shpërblimi total dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është 15,813,840 Lekë.

37. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit. Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Shoqëria ka marrë hua afatgjatë me interes të ndryshueshëm dhe me interes fiks. Shoqëria përballet me riskun e normave të interesit të fluksit të parasë lidhur me riskun e normave të interesit të çdo depozite afatshkurtër.

Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi këtij risku.
Detajimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2017 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017
Instrumenta me interest fiks	
Aktive Financiare	-
Detyrime Financiare	92,199,309
	92,199,309
Instrumenta me interest variable	
Aktive Financiare	
Detyrime Financiare	1,056,589,721
	1,056,589,721

37. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.
Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

	31 dhjetor 2017					
Përshkrimi	**Te pamaturuara**	**Deri në 6 muaj**	**6 deri 12 muaj**	**1 deri 5 vjet**	**Mbi 5 vjet**	**Total**
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	729,699,351	142,541,601	35,770,440	216,940,866	808,240	1,125,760,498
Mjete monetare në arkë dhe bankë		168,401,324				168,401,324
Totali	**729,699,351**	**310,942,925**	**35,770,440**	**216,940,866**	**808,240**	**1,294,161,822**

	31 dhjetor 2016					
Përshkrimi	**Te pamaturuara**	**Deri në 6 muaj**	**6 deri 12 muaj**	**1 deri 5 vjet**	**Mbi 5 vjet**	**Total**
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	541,852,312	129,995,138	15,346,740	146,670,953	265,230	834,130,373
Mjete monetare në arkë dhe bankë		69,805,389				69,805,389
Totali	**541,852,312**	**199,800,527**	**15,346,740**	**146,670,953**	**265,230**	**903,935,762**

37. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkuruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

	31 dhjetor 2017				
Përshkrimi	**Deri në 6 muaj**	**6 deri 12 muaj**	**1 deri 5 vjet**	**Mbi 5 vjet**	**Total**
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	1,024,672,504	11,247,347	89,840,647	-	1,125,760,498
Mjete monetare në arkë dhe bankë	168,401,324				168,401,324
Totali	**1,193,073,828**	**11,247,347**	**89,840,647**	**-**	**1,294,161,822**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(1,901,389,548)	(454,841,787)	(303,610,150)	(10,104,049)	(2,669,945,534)
Hua	(709,573,983)	(161,876,827)	(347,604,600)	-	(1,219,055,410)
Totali	**(2,610,963,531)**	**(616,718,614)**	**(651,214,750)**	**(10,104,049)**	**(3,889,000,944)**
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2017	**(1,417,889,703)**	**(605,471,267)**	**(561,374,103)**	**(10,104,049)**	**(2,594,839,122)**

	31 dhjetor 2016				
Përshkrimi	**Deri në 6 muaj**	**6 deri 12 muaj**	**1 deri 5 vjet**	**Mbi 5 vjet**	**Total**
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	783,280,887	2,955,963	46,306,578	1,586,945	834,130,373
Mjete monetare në arkë dhe bankë	69,805,389				69,805,389
Totali	**853,086,276**	**2,955,963**	**46,306,578**	**1,586,945**	**903,935,762**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(2,159,645,597)	(9,117,116)	(572,126,692)	(15,803,123)	(2,756,692,528)
Hua	(666,478,219)	(98,913,557)	(335,075,992)	-	(1,100,467,767)
Totali	**(2,826,123,816)**	**(108,030,673)**	**(907,202,684)**	**(15,803,123)**	**(3,857,160,295)**
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2016	**(1,973,037,540)**	**(105,074,710)**	**(860,896,106)**	**(14,216,178)**	**(2,953,224,533)**

37. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

	31 dhjetor 2017				
Përshkrimi	**EUR**	**ALL**	**USD**	**Te tjera**	**Total**
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	512,639,799	601,943,045	11,042,699	134,955	1,125,760,498
Mjete monetare në arkë dhe bankë	22,828,256	144,844,648	674,250	54,170	168,401,324
Totali	**535,468,055**	**746,787,693**	**11,716,949**	**189,125**	**1,294,161,822**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(1,825,112,415)	(342,491,224)	(499,737,129)	(2,604,766)	(2,669,945,534)
Hua	(960,171,841)	(258,883,569)			(1,219,055,410)
Totali	**(2,785,284,256)**	**(601,374,793)**	**(499,737,129)**	**(2,604,766)**	**(3,889,000,944)**
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2017	**(2,249,816,201)**	**145,412,900**	**(488,020,180)**	**(2,415,641)**	**(2,594,839,122)**

	31 dhjetor 2016				
Përshkrimi	**EUR**	**ALL**	**USD**	**Te tjera**	**Total**
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	530,372,433	299,914,650	3,705,797	137,493	834,130,373
Mjete monetare në arkë dhe bankë	6,876,659	62,561,461	202,183	165,086	69,805,389
Totali	**537,249,092**	**362,476,111**	**3,907,980**	**302,579**	**903,935,762**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(1,884,037,295)	(383,981,589)	(484,249,509)	(4,424,135)	(2,756,692,528)
Hua	(693,169,049)	(407,298,718)			(1,100,467,767)
Totali	**(2,577,206,344)**	**(791,280,307)**	**(484,249,509)**	**(4,424,135)**	**(3,857,160,295)**
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2016	**(2,039,957,252)**	**(428,804,196)**	**(480,341,529)**	**(4,121,556)**	**(2,953,224,533)**

38. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiare përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.
Aktivet financiare përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.
Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proçes likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

39. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme
Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

40. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore
Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore
Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

41. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.